



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 19.1.2018, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Enver Hoti, Driton Çausi dhe Salih Salihu.

Munguan: Danush Ademi dhe Sergjan Mitroviç

Stafi mbështetës i komisionit: Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.12.2017;
3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së komisionit për vitin 2018;
5. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit, i ftuar kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit;
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi**, pasi i përshëndeti anëtarët e komisionit dhe ju uroi punë të mbarë në sesionin pranveror, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.12.2017**

**Kryetari i komisionit** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### 3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për vitin 2017

**Kryetari Daut Haradinaj**, e paraqiti raportin e punës së komisionit për periudhën shtator-dhjetor 2017 dhe tha se gjatë kësaj periudhe, komisioni ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta, ka formuar 2 grupe punuese, të cilat kanë mbajtur 2 mbledhje dhe ka realizuar 3 vizita brenda vendit. Në mbledhjet e komisionit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, ministrat e resorëve përkatës për bujqësi e mjedis, udhëheqës të agjencive e departamenteve përkatëse. Komisioni, gjithashtu ka shqyrtuar në parim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, ndërsa ka filluar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bujqësinë e zhvillimin rural dhe Ligjin për ndërtim dhe i ftoi deputetët që të miratojnë raportin.

**Besa Gaxherri**, tha se gjatë kësaj periudhe, komisioni, edhe pse ka pasur pak punë dhe aktivitete, e falënderoi personelin mbështetës që i ka përfshirë në këtë raport të gjitha aktivitetet e realizuara.

*Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

#### ***Përfundim***

*Miratohet Raporti i punës së komisionit për periudhën shtator-dhjetor 2017.*

### 4. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së komisionit për vitin 2018

**Kryetari Daut Haradinaj**, para deputetëve e paraqiti draft-planin e punës për vitin 2018 dhe tha se, bazuar në Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2018, komisioni planifikon të shqyrtojë 19 projektligje, prej tyre 11 projektligje nga fusha e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe 8 nga fusha e bujqësisë, pylltarisë e zhvillimit rural. Gjithashtu, komisioni do të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për bujqësinë e zhvillimin rural dhe Ligjin për ndërtim, si dhe do të shqyrtojë raportet e agjencive të pavarura dhe strategjitë sektoriale të mjedisit dhe bujqësisë. Ky plan, shtoi ai, gjatë shqyrtimeve të mëvonshme mund të ndryshojë sipas nevojave dhe prioriteteve, prandaj i ftoi deputetët të ofrojnë propozimet e tyre.

**Liburn Aliu**, për grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërtim, të cilin e kryeson, kërkoi të shtyhet afati i përfundimit të raportit, deri në fund të korrikut, për arsye se pas zgjedhjeve lokale janë ndërruar drejtorët komunalë të urbanizmit dhe se atyre u duhet pak kohë, dhe ne si grup punues, duhet që vizitat e planifikuara nëpër komuna t'i shtyjme për muajt mars dhe prill.

**Andin Hoti**, për grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të cilin e kryeson, tha se i kemi mbajtur dy mbledhje dhe kemi realizuar një vizitë në MBPZHR dhe i ftoi anëtarët e grupit punues, që të marrin pjesë në mbledhje dhe aktivitete të këtij grupi.

**Enver Hoti**, propozoi që në muajt mars ose prill të ftohen ministrat e dy ministrive raportuese, për raportin e investimeve kapitale.

**Salih Salihu**, propozoi që në plan të shtohet edhe nisma për hartimin e Projektligjit për cilësinë e bukës, të cilën e arsyetoi me atë se ne nuk e dimë se çfarë buke konsumojmë, sepse në treg gjejmë bukë me standarde të ndryshme, si për nga pesha, vëllimi, por edhe cilësia, prandaj duhet të kemi një standard të bukës dhe këtë mund ta arrijmë përmes një ligji. Kjo iniciativë u përkrah nga komisioni.

**Kryetari Daut Haradinaj**, paraqiti kërkesën e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, për nismën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, e cila u përkrah nga komisioni.

Me propozimet e paraqitura nga anëtarët e komisionit, *komisioni, njëzëri nxori këtë:*

#### ***Përfundim***

## **5. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen e mjedisit për vitin 2016, i ftuar kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit**

**Kryetari Daut Haradinaj**, e falënderoi kryeshefin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, z. Ilir Morina për prezencën në mbledhje, për të paraqitur raportin për gjendjen e mjedisit për vitin 2016, për të cilin tha se nuk kemi arritur ta shqyrtojmë në fund të vitit të kaluar. Për gjendjen e mjedisit, ndikimin në shëndetin e popullatës dhe për masat që janë duke u ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit, e ftoi kryeshefin që të marrë fjalën.

**Ilir Morina, kryeshef i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit**, në ekspozenë e tij, tha se raporti është bazuar në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe qëllimi i tij, në radhë të parë është informimi i Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për gjendjen e mjedisit, me qëllim të nxitjes së hartimit të politikave adekuate mjedisore. Ai shtoi se raporti është real dhe i njëjti, pas miratimit në Kuvend, paraqitet edhe në Agjencinë Evropiane për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ai, në vazhdim, paraqiti gjetjet kryesore të raportit: **për cilësinë e ajrit**, tha se tejkalimet më të shpeshta të vlerave limite janë regjistruar për grimcat e PM10 dhe PM 2.5 në Prishtinë, Obiliq e Drenas, ndërsa ka pasur raste të tejkalimeve edhe për vlerat limite të Ozonit, CO, NO. Krahasuar me vitin 2015, nuk vërehet ndonjë ndryshim në cilësinë e ajrit. Njëjtë, sikurse gjatë vitit 2015, edhe gjatë vitit 2016, tejkalime janë regjistruar kryesisht për parametrat PM 10 dhe PM 2.5. Edhe gjatë vitit 2017, paraqiten ndotje të përafërta, sikurse në periudhat e njëjta të viteve paraprake, sepse burimet janë të njëjta. Në **sektorin e ujërave**, shqetësues është rritja e trendit të shfrytëzimit të pakontrolluar të inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe shkatërrimi i tyre, ndërsa për **ujërat sipërfaqësore**, tha se nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi. Për ndikimin e ndotjes së mjedisit në **shëndetin publik**, tha se shkakton një seri sëmundjesh tek njerëzit, si: alergjitë e ndryshme, sëmundjet e lëkurës, diarre, sëmundjet respiratorë dhe sëmundje tjera. Ndërsa, për cilësinë **ujit të pijshëm**, që u ofrohet konsumatorëve në 44 zona të furnizimit, të shtrira në zonat e shërbimit të shtatë KRU-të, është 99.2% në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq 98.0% në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.3%. Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat i 50,289 testeve të kryera gjatë vitit 2016 nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Parametrat e **ndotjes së tokave**, tregojnë se në toka bujqësore, rezultatet janë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se rastet e identifikuar me ndotje me metale të rënda, janë kryesisht në zonat industriale. Shqetësues është fakti lidhur me trendin e rritjes së ndryshimit të destinimit të tokave bujqësore në zona ndërtimore dhe industriale. Ndërsa, për **mbeturinat**, tha se vazhdon trendi i rritjes së gjenerimit të tyre dhe sasisë së mbeturinave të deponuara, ndërkohë që është shënuar progres në eliminimin e deponive ilegale nga komunat, por jo edhe në menaxhimin e deponive sanitare nga kompanitë përkatëse. Gjatë vitit 2016, janë deponuar 367,400.83 tonë, dhe sipas studimit të agjencisë me GIZ-in, në 17 komuna të Kosovës janë regjistruar mbi 1117 deponi ilegale. Ende nuk ka sistem të riciklimit të mbeturinave dhe as sistem të rimbursimit të ambalazhit.

Në sektorin e mbrojtjes së natyrës, gjatë vitit 2016, janë marrë në mbrojtje 67 zona të reja të natyrës, por ndikimi në zonat e mbrojtura dhe në biodiversitet është evident, për shkak të ndërtimeve ilegale, prerjeve të pakontrolluara dhe gjuetisë ilegale. Për **inspektimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjit**, tha se gjatë vitit 2016 janë realizuar: 577 vizita inspektuese me procesverbal, 29 vendime për inspekte, 57 inicime në gjykatë për kundërvajtje dhe 530 rekomandime dhe njoftime. Ndërsa, në sektorin e mbrojtjes së natyrës, gjatë vitit 2016, agjencia në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar Sharri, ka përgatitur 98 kallëzime penale, janë bërë 18 kërkesa për fillimin e procedurave kundërvajtëse, 93 kërkesa për iniciimin e propozim padive për kontest civil dhe kërkesa për përmbarrim. Sa i përket **dhënies së lejes**, gjatë vitit 2016, janë

lëshuar rreth 131 pëlqime mjedisore, 53 leje mjedisore dhe 10 licenca për menaxhimin e mbeturinave. Në sektorin e ujërave, janë dhënë edhe 29 leje të reja ujore, 6 pëlqime ujore, 38 kushte ujore dhe janë vazhduar 6 leje ujore.

**Buxheti** i dedikuar për MMPH-në, në vitin 2016 ka pasur një rritje të ndjeshme, krahasuar me vitin paraprak, mirëpo buxheti për shpenzime kapitale, në shumë raste, nuk orientohet në projekte mjedisore por në projekte tjera, që realizimi i tyre nuk ka ndikim në përmirësimin e mjedisit. Në fund, ai paraqiti edhe rekomandimet e raportit dhe ftoi që të mbështetet ky raport, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të mjedisit dhe gjendjes mjedisore.

Pas kësaj ekspozite, diskutuan anëtarët e komisionit.

**Kryetari Daut Haradinaj**, pyeti për taksën që paguajnë qytetarët në hyrje në Brezovicë: sa po kontribuon kjo në sigurimin më të mirë të parkingjeve dhe kushteve tjera për gjendjen e ndotjes me mbeturina dhe për tabelat njoftuese?

**Liburn Aliu**, pyeti për dallimin e Raportit për vitin 2017, në krahasim me këtë që po e shqyrtojmë sot. Pastaj sugjeroi që vërejtjet dhe rekomandimet është mirë të adresohen, se cilat institucione janë përgjegjëse. Ndërsa, për laurën në Brezovicë, tha se është dakord, por nuk duhet harruar edhe pjesët tjera të parkut nacional. Ai përmendi vendin Strazhë të Lubotenit, për të cilën tha se ka dëme të mëdha në pyje dhe degradim të madh, por edhe pjesët e tjera në Suharekë, Shtërpcë, Kaçanik e Dragash.

**Salih Salihu**, tha se raporti e paraqet gjendjen e mirë, ndërsa rekomandimet i paraqesin problemet. Në terren ka probleme të shumta me pyje, lumenj dhe tokën bujqësore. Dëme të mëdha paraqiten nga shfrytëzimi i zhavorrit nëpër kodra dhe propozoi që sipas modeleve të Austrisë, këto gropa, pas shfrytëzimit, të bëhen liqene artificiale. Ndërsa sa i përket ndotjes së tokës me pesticide dhe metale të rënda, duhet të adresohet se kush është përgjegjës për këtë.

**Besa Gaxherri**, tha se mjedisi është në gjendje të rëndë dhe koha është të merren masa dhe mjedisi ka një kosto të lartë. Ajo theksoi se tejkalimi i ndotjes së ajrit nuk është gjatë verës, por gjatë dimrit dhe nga kjo mund thuhet se veturat nuk janë ndotësi më i madh, por lëndët djegëse për ngrohje. Në “Liqenin e kaltër”, i krijuar nga termocentrali dhe se i ka parë fëmijët duke hyrë në të dhe pyeti: sa janë të rrezikuar nga sëmundje të ndryshme dhe çka është ndërmarrë për këtë, kush është përgjegjës nëse atyre u ndodh diçka? Pse nuk ka asnjë investim në riciklim të mbeturinave dhe pse nuk ka asnjë leje për këtë, a ka projekt konkret për të hyrat e grumbulluara nga hyrjet në parqe?

**Ganimete Musliu**, tha se duhet edhe të ofrohen shërbime më të mira për qytetarët që e vizitojnë Brezovicën dhe pyeti: a ka ndonjë rast shembull për trajtimin e mirë të mbeturinave si ndonjë qytet ose lagje dhe cila është gjendja e inkasimit të mbeturinave? Cila është gjendja e inspektorëve?

**Driton Çausi**, për ndotjen e tokave, pyeti: çka nënkupton me konstatimin se rezultatet tregojnë se janë brenda standardeve të lejuara dhe ka trend të rritjes? Ai shtoi se ndotja e tokave është një problem, po ashtu edhe mostrajtimi i ujërave të zeza, dhe nga e gjithë kjo, vije deri te ndotja e ujërave nëntokësore dhe e ujit të pijshëm, prandaj dhe matja e ujërave sipërfaqësore nuk mjafton. Cilat janë vlerësimet për potencialin ndotës të termocentralit të ri dhe ndikimet e tij?

**Enver Hoti**, lidhur me inspektimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjit, pyeti: kush janë operatorët ekonomikë, për të cilët janë marrë këto vendime, kallëzime penale, pastaj u angazhua edhe për leje-dhënie dhe licencat, konkretisht në numrin e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore, që nuk është e qartë. Në fund, ai tha se raportit është mirë që t'i bashkëngjitet një raport financiar.

**Andin Hoti**, shtoi se pajtohet me vërejtjet e kolegëve dhe se duhet kushtuar më shumë vëmendje degradimit të shtretërve të lumenjve, si shembull përmendi shtratin e lumit Drin.

**Illir Morina**, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve: për laurën në Brezovicë dhe për dëmet në zona tjera të Parkut të Sharrit, tha se kanë qenë në bashkëpunim me kryetarin e Komunës së Shtërpcës dhe se reagimi i vendosjes së saj ka qenë pozitiv, mirëpo edhe më shumë duhet të bëhet sa i

përket numrit të madh të fluksit të vizitorëve me automjete dhe mungesës së parkingut. Sa i përket çmimit të hyrjes, ai tregoi çmimet e vendosura: për personat deri në 10 vjet, është falas, personat prej 10-18 vjet, 50 cent, ndërsa për personat e rritur 1 euro. Për automjete 1 euro, kombibusët 2 euro dhe për autobusë 3 euro. Ndërsa, sa i përket dëmeve në Strazhë dhe vende tjera të parkut nacional, ai tha se jemi duke punuar për këtë, mirëpo theksoi mungesën e punëtorëve të mjaftueshëm dhe se agjencia ka vetëm 8 rojtarë për 54 000 ha sipërfaqe.

Ai shtoi se Prishtina nuk është në rajon kryeqyteti me ajrin më të ndotur, sepse gjithmonë ia kalon Shkupi, Tetova, Sofje, ndërsa pajtohet se gjatë sezonit të dimrit ndotja është më e madhe, për shkak të lëndëve djegëse për ngrohje, por edhe kushteve meteorologjike të stinës. Për “Liqenin e kaltër”, thotë se është me pasoja të rënda për lëkurën, por edhe vdekjeprurëse për ata që lahen në të, është problem mjedisor, por nuk kanë leje mjedisore, ndërsa për këtë përmendi ligjin e mjedisit dhe konventën e Aarhusit, që parasheh që secili qytetar duhet të jetë i informuar, të marrë pjesë në vendime, por secili ka të drejtë edhe për padi ndaj operatorit ose dikë tjetër për një dëm. Për riciklimin e mbeturinave, tha se 60 % e tyre janë organike dhe nuk përdoren dhe 40% janë pak për të ndërtuar impiant. Ndërsa, shtoi se ka disa leje për riciklim të plastikës, letrës, disa metaleve, ndërsa për menaxhimin dhe inkasimin në mbeturina e përmendi rajonin e Prizrenit, si shembull të mirë. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore bëhet direkt nga Instituti Hidrometeorologjik, sipas një projekti të suksesshëm, së bashku me GIZ-in gjerman. Për impaktin e termocentralit të ri dhe për ndotjen e mundshme, ai tha se edhe për 30 vitet e ardhshme do të jetë në suaza të normave të lejuara. Krijimi i fondit ekologjik do të ishte shumë i mirëpritur dhe se do të mund të bëhet më shumë për mbrojtjen e mjedisit, pasi që kudo në botë ndotësi paguan, prandaj kërkoi edhe ndihmën e deputetëve për këtë. Ndërsa, për dallimin në mes të raportit ekzistues dhe atij që është në përgatitje, ai tha se në raportin e 2017 do të përfshihen disa projekte milionëshe për mjedis, të dedikuara për matjen e cilësisë së ajrit, për impiantet e ujërave të zeza etj. , të mbështetura nga institucionet ndërkombëtare, si: SIDA suedeze, JICA japoneze, etj.

**Kryetari Daut Haradinaj**, e falënderoi kryeshefin për raportin në komision dhe kërkoi që agjencia dhe ministria duhet ta rrisin aktivitetin në sensibilizimin e qytetarëve, e sidomos nxënësve nëpër shkolla për mbrojtjen e mjedisit dhe në emër të komisionit i ofroi përkrahje kësaj agjencie.

*Në fund, komisioni, në mungesë kuorumi, votimin e Raportit për gjendjen e mjedisit e shtyu për mbledhjen e radhës.*

## **6. Të ndryshme**

Në të ndryshme, kryetari i paraqiti këto çështje dhe i propozoi për mbledhjen e radhës:

- Shpallja e konkursit për drejtor të Agjencisë së Komplekseve Memoriale të Kosovës, pasi që mandati i drejtorit aktual skadon më datën 11 korrik 2018 dhe sipas Ligjit nr. 04/L-146 për Agjencinë për Mbrojtjen e Komplekseve Memoriale të Kosovës, komisioni, 6 muaj para skadimit të mandatit të drejtorit të agjencisë, inicion veprimet për zgjedhjen e drejtorit të ri.
- Kërkesa Shoqatës së Verëtarëve “Enologjia”, për mbështetje për eksportin e verërave dhe heqjen e akcizës në verëra.
- Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.
- Formimi i grupeve punuese për nismën legjislative për hartimin e Projektligjit për ndryshim plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe nismën legjislative për hartimin e Projektligjit për cilësinë e bukës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i komisionit.**

Kryetar i komisionit,  
Daut Haradinaj